



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:229797

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05375833

P.nr.1035/22

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues **Veli Kryeziu**, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fikrije Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.. S....nga Gjilani, për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 p.2 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1983/2022, të datës 07.11.2022, jashtë seance dhe sipas detyrës zyrtare me datën **26.02.2024**, merr këtë:

AKTVENDIM

- I. **HUDHET** poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1983/2022 e datës 07.11.2022 dhe
- II. **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit B... S... nga Gjilani, për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 p.2 të KPRK-ës, si pasojë e mos veprimit sipas kërkesës së kësaj gjykate me të cilin i është bërë thirrje organit të ndjekjes për plotësimin e aktit akuzues ashtu siç kërkohet me nenin **441 të KPP-së**.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 07.11.2022, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1983/2022, kundër të pandehurit B... S.... nga Gjilani për për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 p.2 të KPRK-ës,

Gjykata duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit,PN.nr.1473/2023 të datës 04.12.2023, si dhe pas kontrollit të aktakuzës gjeti se aktakuza lëndore nuk i përmban të gjitha të dhënat që kërkohen

sipas nenit 149 par.1. të KPP-ës „përkatësisht kjo aktakuzë është ngritur pa u mar në pyetje i pandehuri,e ku decidivisht cekët se”...se i pandehuri duhet të meret në pyetje nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës.....” ashtu që me datë **08.02.2024** ka kërkuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan që në afat **prej 10 ditësh** të bëjnë plotësimin e aktakuzës komfor nenit 441 të KPP-ës duke i njoftuar të njëjtit edhe për pasojat në rast të mosveprimit sipas kërkesës së gjykatës, mirëpo të njëjtit përkundër se thirrjen për plotësimin e aktakuzës sipas fletë kthesës e kanë pranuar me datë 09.02.2024, plotësimin e aktakuzës pranë kësaj gjykate nuk e kanë dorëzuar as deri me datë 26.02.2024 çka nënkupton se ky afat i dhënë nga ana e Gjykatës ka skaduar.

Komfor nenit 453 paragrafi 1 të KPP-ës është vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 441 paragrafi 4 të KPP-ës është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1035/22, me datë 26.02.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Veli KRYEZIU

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj Gjykate Themelore.